



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 29.05.2024

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
ROSKOVEC, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 4, DATË 10.06.2020
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 4, datë 10.06.2020 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Roskovec”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Roskovec, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 30 datë 26.04.2024, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Roskovec, të miratuar me Vendimin Nr. 4, datë 10.06.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar, të bëhen ndryshime në:

- *Dokumentin e Rregullores së Planit:*
 - Në nenin 15 “*Madhësia e Parcelës*”, pas pikës 6 shtohet pika 7;
 - Neni 86 “*Zhvillimi i Agroturizmit dhe Ekoturizmit*”, ndryshohet;
- *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Roskovec, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Roskovec dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit,

OMMO
RIT
SHOIP
BLIKA



F.S.
KES.

si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.

MINISTRI

Ngarkohen Bashkia Roskovec, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.

- 4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHYLLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

